

V E N D I M
Nr.170, datë 3.4.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.70, DATË
11.3.1985 "PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E
VLERAVE MATERIALE E MONETARE"**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjitike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 19 ndryshohet si vijon:

" a) Pjesët e ndërrimit, instrumentet, veglat e punës, inventari i imët, ambalazhet, materialet, mallrat, makineritë e pajisjet nxirren jashtë përdorimit me miratim të këshillave drejtues të ndërmarrjeve, institucioneve e korporatave, kurse për ndërmarrjet e institucionet buxhetore mbeten në kompetencë të drejtorit të tyre.

Bëhet përjashtim për kaldajat e avullit me kapacitet mbi 12 tonë avull në orë, turbinat me avull, hidroturbinat me fuqi mbi 5.000 KW, sondat për shpime të thella të naftës, ekskavatorët me kapacitet 0,5 m³ e lart, buldozierët 80 kuaj-fuqi e lart, lokomotivat hekurudhore, vagonët për udhëtarë, kamionët 10 tonë e lart, mjetet detare dhe makineritë e sektorit ushtarak, nxjerrja jashtë përdorimit e të cilëve bëhet me miratimin e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore përkatëse. Autobuzët e transportit urban nxirren jashtë përdorimit me miratim të këshillit të bashkisë.

" b) Materialet në përdorim të ushtrisë dhe të rendit publik, për të cilat janë caktuar afate përdorimi, nxirren jashtë përdorimit sipas përcaktimit që bëjnë Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik."

2. Neni 20 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi